

VENDIM
Nr. 157, datë 29.12.2014

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË
SHOQËRISË “UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË” SHA PËR TRANSFERIMIN E
LICENCËS SË TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA SHOQËRIA
“UJËSJELLËS KANALIZIME TIRANË” SHA TEK SHOQËRIA “HECLANABREGAS”
SHA**

Në mbështetje të nenit 9 dhe 20, pika 1 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, nenit 17, të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e datës 29.12.2014, pasi shqyrtoi kërkesën e “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sh.a., licencuar në aktivitetin etregtimit të energjisë elektrike me vendimin nr. 137, datë 6.12.2011, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, si edhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

konstatoi se:

- “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sh.a. në cilësinë e shoqërisë që kërkon të transferojë licencën, ka plotësuar pjesërisht dokumentacionin e nevojshëm për të kryer këtë procedurë referuar rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”.

- “HecLanabregas” sh.a., që kërkon të marrë licencën “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sh.a. eka paraqitur dokumentacionin enë bazë të nenit 9 të rregullores “Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave”.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurat për transferimin e licencës së tregtimit të energjisë elektrike të shoqërisë “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sh.a., shoqërisë “HecLanabregas” sh.a.

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit ngarkohet për njoftimin e shoqërive “Ujësjetllës Kanalizime Tiranë” sh.a., dhe “HecLanabregas” sh.a. për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti